



Raport Muaji Shkurt 2026

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes	03 Shtator 2018
Fillestare	
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	1% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa e vazhdueshme	1.27% per vitin 2025
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.


Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.27% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2025. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund te kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta




Profil i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 28.02.2026

Vlera Neto e Aseteve	11,610,383,760
Numri i investitoreve	4,346
Çmimi i Kuotes	1,330.9052
*Kthimi vjetor neto nga investimi (28.02.2025 – 28.02.2026)	3.05%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 28 Shkurt 2026



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar. Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80% e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitorëve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 11.6 miliardë në datë 28 Shkurt 2026.

Instrumenti	Në % të Asetëve të Fondit
Obligacione Thesari	84.4%
Bono Thesari	0.8%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Të arketueshme	14.7%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 10 dhe 15 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në muaj për secilin maturitet.

www.raiffeisen-invest.al


Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Shkurt

Gjate muajit Shkurt norma bazë e interesit eshte e pandryshuar në nivelin 2.50%. Nderkohe, norma e inflacionit mbetet në nivele të ulëta dhe nën kontroll sipas Bankës së Shqiperise. Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend renes gjate muajit Shkurt, pervec bonos 12-mujore. Yildi i bonos 12 mujore rezultoi ne 2.434%, duke u rritur me 0.03% ne krahesim me ankandin paraardhes.

Persa i perket obligacioneve ne krahesim me ankandet e fundit: Yildi i obligacionit 2.5 vjeçar rezultoi ne 3.10% duke rrene me 0.21%; Yildi i obligacionit reference 3 vjeçar rezultoi ne 3.117% duke rrene me 0.31%; Yildi i obligacionit reference 5 vjeçar rezultoi ne 3.56% duke rrene me 0.22%; Yildi i obligacionit 7 vjeçar rezultoi ne 4.11% duke rrene me 0.66% dhe Yildi i obligacionit 15 vjeçar rezultoi ne 5.67% duke rrene me 0.52%.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Shkurt 2025 – Shkurt 2026. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Shkurt.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 28 Shkurt 2026

Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 28 Shkurt 2025 – 28 Shkurt 2026 eshte 3.05%.

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur me 1.26% gjate muajit Shkurt. Renia e normave te interesit per obligacionet e Qeverise Shqiptare ka ndikuar pozitivisht ne portofolin e investimeve te fondit.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlere e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminiimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 28 Shkurt 2026	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	3.05%	7.13%	6.50%	4.27%	3.67%	3.89%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Për çdo shlyerje apo këmbim të kryer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh, do të aplikohet tarifë dalëse. Kjo tarifë është 1% për investimet e kryera në fond nga data 15 Janar 2025.

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitorët e fondit Vizion dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter. Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.